



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0952

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare duke vendosur sipas ankesës së OE G-PROJECT, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i rrugëve të arave për nevojat e Bujqësisë” me numër të prokurimit 651-23-10094-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL-GJILAN, më 08/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e G-PROJECT me nr. 2023/0952, e datës 27/11/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i rrugëve të arave për nevojat e Bujqësisë”, me numër të prokurimit 651-23-10094-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.

2. Vërtetohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues KUVENDI KOMUNAL - GJILAN, i datës 09.11.2023.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 20.09.2023, KUVENDI KOMUNAL - GJILAN në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Rregullimi i

rrugëve të arave për nevojat e Bujqësisë”, me numër të prokurimit 651-23-10094-5-2-1. Ndërsa me datën 09.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 13.11.2023, OE G-PROJECT ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE G-PROJECT me nr. 952/23 lidhur me aktivitetin “Rregullimi i rrugëve të arave për nevojat e Bujqësisë”, me numër të prokurimit 651-23-10094-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE G-PROJECT janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon se “*Tenderi/oferta jonë është konstatuar si tenderues i eliminuar duke ju referuar arsyetimit se grupi i konzorciumit nga ana jonë nuk ka plotësuar kërkesën 3 : ku OE duhet të Dëshmoj, të ofroj dëshmi mbi Certifikatat e kërkuara. Mirëpo, arsyetimi ti AK-së nuk qëndron dhe respektivisht është i pabazuar në relacion me gjendjen faktike dhe bazën ligjore, sepse dosja e tenderit e dorëzuar nga ana e OE: “Domid” sh.pk & G-Project” sh.p.k & Conex L.L.C, ka plotësuar në tërësi të gjitha kriteret e kualifikuese dhe të për zgjedhjes të specifikuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit për projektin: “Rregullimi i rrugëve të arave për nevojat e Bujqësisë” me numër të prokurimit: 651-23-10094-5-2-1. Lideri i këtij grupi G-Project sh.p.k ka plotësuar 60% të kapaciteteve teknike dhe profesionale poashtu ka plotësuar edhe kërkesën me numër 3: duke i ofruar të 2 certifikata dhe me valeditet pra jo të skaduara, në dosje është dashur nga ana e AK-së të specifikohet që të gjithë OE duhet të kenë certifikatat e caktuara apo ta specifikoj vetëm liderin, pasi që në raste të tilla tenderimi ë afate kohore aq të shkurtë ku sipas kësaj lënde tenderimi ku me 20.09.2023 është dorëzuar në Krpp dhe se hapja ka qenë me 06.10.2023 ku që të certifikohen shpesh*

kompani të tilla është e pamundur pasi që certifikimi të tilla zgjasin më muaj, prandaj lideri në këtë kërkesë sipas dosjes të prezantuar nga ana juaj plotëson kërkesen nr 3. Andaj përzgjedhja e grupit OE: COMPANY ZUKA' SH.P.K,dhe eliminimi i anës tonë për grupin OE: "Domid" sh.pk &G-Project" sh.p.k & Conex L.L.C, për argumentete që keni shfaqur për mos përmbushje, dhe se në dosjen e tenderit është specifikuar detali ndryshe, ne si OE konsiderojmë se ju AK-Kuvendi Komunal i Gjilani ka shkelur nenin 28 dhe 29 i ndërlidhur me nenin 19 paragrafi 19.1 dhe 19.2-RRPP, Neni 59, 69 dhe neni 25 RRPP; nenin 27 i ndërlidhur me neni 17 paragrafi 17.5 RRPP."

Pretendimi i dytë (II) Ankuesi pretendon se: *"Tenderi/oferta jonë është konstatuar si tenderues i eliminuar duke ju referuar arsyetimit se grupi i konzorciumit nga ana jonë nuk ka plotësuar kërkesën 2 respektivisht piken d. Mirëpo, arsyetimi ti AK-së nuk qëndron dhe respektivisht është i pabazuar në relacion me gjendjen faktike dhe bazën ligjore, sepse dosja e tenderit e dorëzuar nga ana e OE: "Domid" sh.pk &G-Project" sh.p.k & Conex L.L.C, ka plotësuar në tërësi të gjitha kriteret e kualifikuese dhe të përzgjedhjes të specifikuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit për projektin: "Rregullimi i rrugëve të arave për nevojat e Bujqësisë" me numër të prokurimit: 651-23-10094-5-2-1. Ne si grup i OE: "Domid" sh.pk &G-Project" sh.p.k & Conex L.L.C, kemi paraqitur inxhinierin e gjeodezisë Z. Shaqir Kuqi ku inxhinieri ka përvojë pune dhe se kopjen e diplomës universitare e ka te noterizuar nga origjinale, ka marrëveshje me këtë konzorcium mbi angazhimin e këtij projektin, ka CV e nënshkruar dhe ka referenca pune të dokumentuar ka licencën valide me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të punojë dhe të veproj sipas rregulloreve, andaj pretendimet e AK-së se inxhinieri i prezantuar nga ana jonë ka diplomën në gjuhë kroate, dhe se gjuhë zyrtare sipas Krpp njihen vetëm gjuha, shqipe, anglishte, serbe, e ku edhe gjuha kroate është e përafërt me gjuhen serbe ndryshe e gjuajtur serbo-kroate, sipas pretendimeve nga ana jonë se AK ka vepruar në kundërshtim neni 59 kryesisht paragrafi 2 dhe 4 të ligjit të Nr. 02/L-042; ku AK ka mundur të kërkojë një informatë shtesë apo sqarim shtesë ku ka mundur të kërkojë diplomën e përkthyer e që inxhinieri jonë e ka të përkthyer vetëm që nuk është prezantuar në dosjen e tenderit për shkak se sipas dosjes së tenderit është kërkuara: kopjen e diplomës universitare të noterizuar nga origjinali, kontrata valide kopje ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin, CV, referenca pune. Nëse do të ishte kërkuar një sqarim i tillë e që AK mos të veproj në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 2 dhe 4 të ligjit të Nr 02/L-042, pretendimet e AK janë të pa baza, vetëm në mënyrë që oferta jonë të eliminohet dhe që të cenohet e drejta dhe interesat ligjore me interesin material të kësaj kontrate."*

Pretendimi i tretë(III) - Ankuesi pretendon se: *"Me datën 09.11.2023 pasi kemi pranuar njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues për shpalljen e tenderuesit të suksesshem OE: "Company Zuka Commerce sh.p.k", ne pas marrjes e vendimit kemi parashtruar përmes email kemi parashtruar kërkesë për qasje në dokumentacion, e ku AK-Kuvendi Komunal Gjilanit e ka aprovuar kërkesën për qasje, mirëpo përkundër këtij fakti ne praktike kur kemi shkuar, qasja nuk na është lejuar siç kemi kërkuar dhe e përcakton neni 10 dhe 11 të LPP-se në rastet kur ka dokumente si sekrete afarist. Qasja ne dosjet e tenderuesve nuk na eshte siguruar me arsyetimin se nga ana e tyre është parashtruar kërkesë për sekrete afariste. Andaj duke u bazuar tek Aneksi 3: i dorëzuar nga AK-Komuna e Gjilanit tek ne OE: "Domid" sh.pk &G-Project" sh.p.k & Conex L.L.C,i pranuar me datën 10.11.2023 kur ishim në qasje, shihet qartë se OE: "Company Zuka Commerce sh.p.k", dokumentacion që ka prezantuar në dosjen e tenderit ka vepruar në*

kundërshtim me rregulloren e KRPP, dhe duke mos e dhënë saktë deklarin për sekrete afarist-(Kërkesë për konfidencialitet Aneksi 3), e ku OE duhet ku edhe sipas dosjes se tenderit respektivisht pika 10. Informatat sekrete afariste 10.1 Nëse operatori ekonomik dëshiron që ndonjë informatë lidhur me gjendjen ekonomike /financiare dhe aftësitë teknike/profesionale të trajtohet si informatë sekrete afariste, duhet të dorëzoj një kërkesë me shkrim duke përdorur formën e caktuar në këtë dosje të tenderit, shih Aneksin 3. Pas ri-shqyrtimit të lëndës, ne kemi pretendime se kompania e përzgjedhur nga AK- për OE fitues duke mos na lejuar qasje, kemi konstatuar në përfundim se OE fitues nuk i ka të gjitha dokumentacionet dhe se dokumentacioni nuk është plotësuar dhe se AK po vepron me shkeljet e njëjta. Në këtë mënyrë, OE ankues vlerëson se vendimi dhe vlerësimi dhe ekzaminimi i tenderëve është bërë në kundërshtim me nenin 59.4, neni 60 paragrafi 1.1 dhe neni 62 të LPP-së dhe dispozitave të legjislacionit sekondar të theksuar si më sipër.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 30.11.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2023/952 ndërsa me datë 12.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/952 me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-se për dhënie të kontratës, të mbetet në fuqi.”*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është deklaruar se pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertin shqyrtues, ndërsa OE nuk është deklaruar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE G-PROJECT eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0952 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin e parë (I) – Eksperti sqaron se sipas arsytimit të parë të eliminimit të OE ankues, eksperti shqyrtues, vlerëson se me të drejte e ka eliminuar për faktin se sipas nenit 26.6 të Rregullores për prokurim publik nr: 001/2022, certifikatat për sigurim të cilësisë duhet të

dëshmoj secili anëtarë i grupit veç e veç.

26.6 Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.

Përgjigje në pretendimin e dytë (II) –Eksperti sqaron se lidhur me arsyen e dyte te eliminimit, ku OE ankues është eliminuar me arsyetimin se ka ofruar dokument/dëshmi e cila është ne kundërshtim me nenin 13 te LPP-se për përdorimin e gjuhëve ne dokumentet e prokurimit, konkretisht ne këtë rast OE ankues ka ofruar diplomën e inxhinierit ne gjuhen kroate.OE ankues lidhur me këtë arsye te eliminimit pretendon se edhe gjuha kroate është e përafërt me gjuhen serbe ndryshe e gjuajtur serbo-kroate. Eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues për faktin se sipas dispozitave te nenit 13 te LPP-se, përdorimi i dokumenteve ne një aktivitet te prokurimit lejohet vetëm ne gjuhen Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Përgjigje në pretendimin e tretë (III) – Eksperti sqaron se OE ankues, pas pranimit te vendimit te AK-se, ka kërkuar qasje ne ofertën e te rekomanduarit për kontrate dhe njëherit pretendon se AK-ja, ka vepruar ne kundërshtim me nenin 10 te LPP-se, për faktin se nuk i ka ofruar qasje ne dokumentet e OE te rekomanduar për kontratë me arsyetimin se ka kërkesë për sekret afarist nga OE i rekomanduar për kontrate.Eksperti shqyrtues pasi ka ekzaminuar ofertën e te rekomanduar për kontrate, e konfirmon se e ka dorëzuar kërkesën për sekret afarist, mirëpo qëndron pretendimi i OE ankues sepse nuk mund te konsiderohen te gjitha dëshmitë e ofertës si sekret afarist.Lidhur me këtë pretendim dhe njëherit duke u bazuar ne arsyet e eliminimit te OE ankues, eksperti shqyrtues, vlerëson OE ankues ne këtë rast kualifikohet si palë pa interes me vet faktin se i njëjti është i papërgjegjshëm dhe se vlerësimi i ofertës se OE te rekomanduar për kontrate mbetet përgjegjësi e autoritetit kontraktues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të refuzohet si e pa bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha

shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertëve shqyrtues dhe mendimi i tyre janë kryesisht të pranueshme nga ana e këtij paneli, për faktin se në këto raporte është konsideruar se janë ofruar argumente, të gjetura dhe fakte të mjaftueshme që si rrjedhojë sjellin rekomandime të qarta, andaj është arritur deri tek vendim-marrja përfundimtare që aktiviteti të mos kthehet në rivlerësim dhe të lihet në fuqi vendimi i AK.

Ankuesi ka atakuar vendimin a AK rreth eliminimit të tij/saj, ku sipas AK, ankuesi është eliminuar për faktin se sipas nenit 26.6 të Rregullores për prokurim publik nr: 001/2022, certifikatat për sigurim të cilësisë duhet të dëshmojnë secili anëtarë i grupit veç e veç. Eksperti vlerëson se me të drejte e ka eliminuar për faktin se sipas nenit 26.6 të Rregullores për prokurim publik nr: 001/2022, certifikatat për sigurim të cilësisë duhet të dëshmojnë secili anëtarë i grupit veç e veç. 26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse. Paneli shqyrtues këtë konstatim të ekspertit shqyrtues e mbështet sepse i njëjti është bazuar dhe argumentuar edhe me dispozitat ligjore në fuqi për Prokurim Publik. Kjo përbënë bazë të mjaftueshme që OE ankues është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Ankuesi ka atakuar vendimin a AK rreth arsyes së dytë të eliminimit të tij/saj, ku sipas AK, ankuesi është eliminuar për faktin se nuk ka plotësuar kërkesën 2 respektivisht pikën d. ngase diploma e Inxhinierit të Gjeodezisë nuk është konform nenit 13 të LPP. Eksperti sqaron se lidhur me arsyen e dytë të eliminimit, ku OE ankues është eliminuar me arsyetimin se ka ofruar dokument/dëshmi e cila është në kundërshtim me nenin 13 të LPP-se për përdorimin e gjuhëve në dokumentet e prokurimit, konkretisht në këtë rast OE ankues ka ofruar diplomën e inxhinierit në gjuhën kroate. OE ankues lidhur me këtë arsye të eliminimit pretendon se edhe gjuha kroate është e përafërt me gjuhën serbe ndryshe e gjuajtur serbo-kroate. Eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues për faktin se sipas dispozitave të nenit 13 të LPP-se, përdorimi i dokumenteve në një aktivitet të prokurimit lejohet vetëm në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Paneli shqyrtues lidhur me këtë konstatim të ekspertit shqyrtues nuk pajtohet dhe në konsistencë edhe me vendimet tjera të OSHP (vendimi Nr. 2023/0437), paneli vlerëson se, sipas kërkesës së lartë cituar në dosjen e tenderit, OE i ankues për kontratë ka dorëzuar diplomën e inxhinierit, por këtë dokument e ka paraqit në gjuhën kroate, pra kjo është e evidente, andaj meqenëse Diploma në fjalë është dorëzuar në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me nenin 13.4 të LPP-së, AK –

komisioni i vlerësimit ka qenë i obliguar të veproj sipas nenin 59.2 dhe 72 të LPPsë. Për faktin se, "Diploma e Inxhinierit" bënë pjesë te neni 69 i LPP-së, si rrjedhojë në përputhje me nenin 72 të LPP-së, AK ka mund të kërkojë nga OE që të dorëzojë, plotësojë apo sqarojë çdo dokument pra "Diplomën" që është kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë për të dëshmuar se OE i posedon mjaftueshëm aftësitë teknike dhe/ose profesionale për të përmbushë kontratën publike. Ky konstatim mbështetet edhe në Opinionet e publikuara në platformën elektronike e-prokurim (Opinionit me Nr. 7 dhe Nr. 13), të cilët sqarojnë, në rastet kur OE sjellin dokumente në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me nenin 13.4 të LPP-së e që kanë të bëjnë me Specifikimet Teknike duhet të përjashtohet, ndërsa për Certifikata dhe dokumente tjera. AK ka mundur të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPPsë. Por meqenëse OE ankues rezulton si i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit atëherë nuk mundet që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe të kërkohej sqarime.

Ndërsa, pohimi i ankuesi sa i përket qasjes në dokumente publike sikurse për ekspertin shqyrtues ashtu edhe për Panelin Shqyrtues ky pretendim cilësohet si i qëndrueshëm, për shkak se qasja në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë ka qenë e kufizuar dhe AK në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura në ankesë, e ka pranuar të gjithë ofertën si sekret afarist. Kjo sipas vlerësimit edhe të panelit paraqet shkelje të nenit 10 dhe 11 të LPP. Andaj për shkak të kësaj shkelje Paneli shqyrtues ju bënë me dije ZPP të AK, se nëse në të ardhmën evidentohet një shkelje e tillë, atëherë OSHP do ti drejtohet KRPP me një kërkesë për revokim të çertifikatës konform neni 25, paragrafit 8 dhe 9 të LPP. Ndërsa, udhëzohet pala që këtë kufizim ta paraqes edhe tek Agjencioni për Informim dhe Privatësi.

Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, rrjedhimisht pasi që Paneli shqyrtues ka konstatuar ashtu sikurse AK, se ankuesi është i papërgjegjshëm (eliminuar) si dhe në bazë të vendimit të AK edhe letrave standarde edhe OE tjerë pjesëmarrës janë të eliminuar dhe nuk kanë parashtruar ankesë (që d.t.th janë pajtuar me eliminimin e tyre), atëherë në zbatim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet të prokurimit edhe më tutje dhe pa ndonjë arsye konkrete dhe në mungesë të ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm, atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Kjo pasi që në qoftë eventualisht aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim dhe qasja mund ti jipet secilit Oe pjesëmarrës, por që realisht të gjithë ofertuesit tjerë përfshirë edhe ankuesin mbi bazën e sqarimeve të mësipërme dhe raportit të komisionit vlerësues profesional brenda AK kualifikohen si palë pa interes juridiko-material sipas nenit 4.1.26 të LPP, ngase të njëjtit në asnjë rethanë nuk mund të jetë fitues potencial mbi bazën e ofertës tyre të kësaj kontrate publike. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat

personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 1 dhe 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik. Po ashtu, duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - G-PROJECT**
- Arkivës së OSHP-së: